



KOMISIONI EVROPIAN LEJOI 17 MILIONË EURO PLOTËSUERE PËR MAQEDONINË DHE SERBINË



Në 8 tetor Komisioni evropian lejoi 17 milionë euro për Republikën e Maqedonisë dhe Serbinë si ndihmë për zgjedhjen e problemit me refugjatët. Nga këto mjete, 10 milionë euro do të jenë të dedikuara për përfundim të kapaciteteve të të dyja shteteve për pranim dhe vendosje të refugjatëve si dhe për kontroll të kufijve, ndërsa 7 milionë eurot tjera për ndihmë humanitare për zbatim me krizën refugjatëve.

Komisioni ndërmori detyrim të sigurojë 200 milionë euro plotësuese për vitin 2015 për ballafaqimin me pasojat nga kriza me refugjatët.

Sipas eurokomesarit për bisedime për zgjerim dhe politikë fqinjësore evropiane Johannes Han "kriza rrjedhëse me refugjatët dhe migrantët është sfidë me dimensione globale. Doemos të punojmë së bashku dorë me dorë me partnerët tanë dhe vende fqinje të cilat janë jashtë nga kufijtë e UE-së, ndërsa të cilat janë më së shumti të prekura". Këto janë mjete të reja të cilat u janë të kapshme pushteteve në Beograd dhe në Serbi, të cilat tashmë bënë shumë për zbatimin e kësaj çështje. Ky është sinjal i rëndësishëm për solidaritetin të vazhdueshëm evropian".

Eurokomesari për ndihmë humanitare dhe ballafaqim me kriza, Hristos Stilianidis deklaroi se që të zgjidhet kriza me refugjatët është e nevojshme ballafaqimi me shkaqet kryesore për shpërngulje me forcë brenda në Siri, Irak dhe Afganistan. Duhet të vazhdojë përkrahja për vendet fqinje të cilat tashmë kanë vendosur numër të madh të refugjatëve. Sipas Stilianidis "Unioni Evropian ka marrëveshje kolektive, të sigurohet mbrojtje dhe ndihmë

humanitare personave më të prekur, pa dallim prej ku vijnë".

Pakoja e re e financave nga 17 milionë euro plotësuese vjen si rezultat i përpjekjeve të Unionit Evropian të ballafaqohet me pasojat nga kriza në Siri.

Përkrahja e plotë paraaderuese në lidhje me aktivitetet të lidhura me migrimin (si paraprake dhe të planifikuara) është 24 milionë euro. Dymbëdhjetë milionë euro janë të ndara në korniza të IPA I komponentit për rinovim të stacioneve policore në kufijtë, lufta kundër tregtisë me njerëz dhe përfundimi i kapaciteteve të policisë për menaxhim me kufijtë.

Nëpërmjet të IPA II për vitin 2016 janë planifikuar të sigurohen 12 milionë euro për përkrahje të Qeverisë së Republikës të Maqedonisë.

Mjetet do të ndihmojnë në zbatimin e politikës të migrimit nëpërmjet aktivitete të shumta, duke përfshirë edhe nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, pajisjes dhe IT përkrahej për funksionim të rregullt të politikave të azili dhe migrimit; përfundim të funksionimit të politikës të vizave; luftës kundër tregtisë me njerëz dhe përkrahje të viktimave të tregtisë me njerëz dhe dhunës; përmirësimi i kushteve në stacionet policore; dhe përfundimi i kapaciteteve për trajnim dhe arsim në sferën e punëve të brendshme.

<http://europa.eu/rapid/press>

Содржина на вест:

| | |
|---|----|
| KE KOMISIONI EVROPIAN LEJOI 17 MILIONË EURO PLOTËSUERE PËR MAQEDONINË DHE | 1 |
| NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN | 2 |
| PESËMBËDHJETË VENDE-ANËTARE TË UE-SË KËRKOJNË NDALESË PËR OGM | 2 |
| PE KËRKOI HETIM PËR SKANDALIN ME TESTET EKOLOGJIKE TË "FOLKSVAGEN" | 3 |
| KRIZA E MIGRANTËVE NË FOKUSIN E TAKIMIT TË KËSHILLIT EVROPIAN | 4 |
| INICIATIVA QYTETARE "STOP TIP+ | 5 |
| NGA NËNTORI BANKËNOTË E RE PREJ 20 EURO | 5 |
| BUJQËSIA EVROPIANE NË ERËN E TEKNOLOGJISË TË RE | 6 |
| "DITË TË HAPURA" JAVA EVROPIANE E REGJIONEVE DHE QYTETEVE | 7 |
| ZGJEDHJE APARLAMENTARE NË POLONI | 8 |
| PARALAJMËRIME TË REJA SHËNDËTËSOREN PAKETIMET TË CIGAREVE | 8 |
| ZGJEDHJE PARLAMENTARE NË PORTUGALI | 9 |
| RAIF BADAVIDI - FITUES I SHPËRBLIMIT SAHAROV 2015 | 10 |
| REFORMË PËR RREGULLAT PËR MBROJTJE TË TË DHËNAVE | 11 |
| UE KALENDAR NËNTOR/2015 | 11 |



Sesioni plenar 5-8 tetor 2015, Strasburg

Gjatë kohës së sesioni plenar të PE, kryetari francez Fransoa Olland dhe kancelaria gjermane Angella Merckel kishin fjalim të përbashkët para euro deputetëve, në tema të lidhura me krizën e refugjatëve, ekonominë, politikën të jashtme.

Për skandalin me testet ekologjike në Follsvagen ishte e diskutuar me Elizabeta Bienkowska, komisarë për treg të vetëm, me ç'rast eurodeputetët ftuan në përmirësim të rregullave për testim të emetimeve të gazrave nga automjetet. Migrimi dhe kriza e refugjatëve si dhe konkluzionet nga takimi i Këshillit Evropian ishin temë e debati me kryetarin e Këshillit, Donalld Tusk dhe kryetari i Komisionit Zhan Klod Juncker.

Më 7 tetor Mbreti spanjoll Filipi VI e vizitoi PE-në dhe u angazhua për sigurim të ndihme për refugjatët.

Eurodeputetët vlerësuan se UE dhe Turqia duhet më së afërmi të bashkëpunojnë për çështjet për Sirinë, por e paralajmëruan Ankaranë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe lirën e medieve.

Sesion plenar 12 tetor 2015, Bruksel

Parlamenti evropian ftoi në zvogëlimin e emetimeve të gazrave qelqor për më së paku 40% deri në vitin 2030. Parlamenti e lejoi propozimin e KE-së, për mjete

plotësuese prej 401,3 milionë euro për menaxhim me krizën e refugjatëve. Mjetet do të jenë të dedikuara për shtetet të cilat janë më së shumti të prekura me refugjatët, për shtetet të cilat nuk janë anëtare të UE-së dhe pranojnë refugjatë nga Siria si dhe për 3 agjenci evropiane të cilat ballafaqohen me kërkesat të lidhura me refugjatët.

Plenar 26-29 tetor 2015, Strasburg

Zgjedhja e krizës të refugjatëve dhe hapja e vendeve të reja të punës janë tema më të rëndësishme në bisedimet për buxhetin e UE-së për vitin e ardhshëm.

Me miratimin e rregullave të reviduara për udhëtarët, paket aranzhman (i cili përbëhet nga udhëtimi me aeroplan, hotel ose qiramarrje të automjeti) i blerë onllajn për çmim të vetëm ose nëpërmjet ueb faqe të lidhura do të ketë mbrojtje të njëjtë si pako i aranzhmani i blerë në agjenci turistike.

Eurodeputetët e votuan pakon e ligjeve për tregun e telekomunikimit, me të cilin ndalesa për kompensim për roaming për shfrytëzim të telefonave celular jashtë vendit por në roaming në korniza të UE-së, do të hyjë në fuqi në qershor të viti 2017.

PE nuk e lejoi draft direktivën <http://www.europarl.europa.eu/news/>

PESËMBËDHJETË VENDE-ANËTARE TË UE-SË KËRKOJNË NDALESË PËR ORGANIZMA GJENETIKISHT TË

Pesëmbëdhjetë nga vendet-anëtare të UE-së kanë kërkuar të ndalohet përdorimi i kulturave gjenetike të modifikuara në territorin e tyre. Ndaj listës të vende-anëtare të cilat kërkojnë ndalesë të plotë për kultivim të OGM, u bashkëngjiten edhe Gjermania dhe Franca.

Britania e Madhe kërkon ndalesë për kultivim të OGM në territorin e Skocisë, Vellsit dhe Irlandës Veriore, duke i lënë mundësi Anglisë vullnetarisht të miratojë vendim për këtë çështje. Në listën janë: Austria, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Holanda dhe Polonia. Belgjika vendosi ta mbajë regjionin Valoni si të lirë për përdorim të OGM.

Sipas Rojters, në letrën nga Ministria e Bujqësisë të Gjermanisë te Komisioni, Ministri gjerman i bujqësisë Kristijan Shmit e ka informuar Komisionin se Gjermania nuk ka të lejojë kultivimin e OGM në territorin e saj. Në Gjermani ekziston pajtim të

përgjithshëm për ndalesë të OGM, por ekziston mospajtim kush do ta zbatojë ndalesën, organet federale ose shtetërore.

Rregullat të reja të UE-së të lejuara në mars këtë vit japin mundësi vende-anëtare të caktuara të ndalojnë kultura OGM edhe pasi ato do të jenë të lejuara si të sigurta nga ana e Komisionit Evropian. Sipas atyre rregullave venet-anëtare doemos deri në 3 tetor 2015 ta informojnë Komisionin Evropian nëse do të pranojnë leje të reja për kultivim të OGM.

Propozimi i cili ishte i përkrahur nga 28 ministra për mjedis jetësor të UE-së në qershor të vitit 2014, e kthen sërish "përgjegjësinë e plotë" të vendeve-anëtare në kultivimin e OGM në territorin e tyre. Për herë të parë mundësohet vendeve anëtare të UE-së edhe formalisht të heqin dorë nga Sistemi i gjerë evropian i lejimit.

<http://www.euractiv.com/sections>

[Click Here to upgrade to
Unlimited Pages and Expanded Features](#)

SKANDALIN ME TESTET EKOLOGJIKE TË "FOLKSVAGEN"

Kryetarët të 4 komiteteve të Parlamentit Evropian kërkuan Komisioni Evropian të hapë hetim për skandalin për falsifikim të emetimeve të gazrave të dëmshëm në kompaninë gjermane të automobilave "Folksvagen".

Më shumë shtete evropiane ndërmjet të cilave edhe Franca, Britania e Madhe dhe Italia deklaruan hetim për këtë çështje, që paraqet alarm për UE-në.

Më 6 tetor këtë vit disa komitete në Parlamentin evropian kërkuan të zbulohen të gjitha detajet në këtë rast. Komisioni evropian dhe vendet-anëtare e shqyrtojnë çështjen për futje të rregullave më të rrepta dhe ftoi në hetim kundër këtë skandal të madh.

kryetarët të komiteteve për mjedis jetësor, transport, treg të brendshëm dhe industri miratuan vendim të hetohet mashtrimi në Folksvagen, të testit ekologjik për lëshim të gazrave të dëmshëm, gjithashtu si do të jetë i futur softuer i cili e detekton sistemin për matje të gazrave të dëmshëm, për shkak të janë marrë tregues të rrejshëm.

Sipas vlerësimeve, në vendet të UE-së lëvizin më shumë se 11 milionë automjet me softuer të futur me të dhëna të rrejshme. Kompania Folksvagen i ka pajisur automjetet e saja me softuer të dizajnuar t'i ndryshojë emetimet në kushte të testimi, duke dhënë rezultate joreale nga testi për 40 herë vlera më të ulëta. Softueri mandej është fshirë dhe automjeti k punuar në regjim normal.

Në parlamentin evropian ishte ngritur peticion nga ana e Partisë të të gjelbërve, me kërkesë Komisioni evropian të hapë hetim për manipulimet me teknologjinë për testet për matje të nivelit të ndotjes. Peticioni për më pakë se një javë grumbullojë më shumë se 110.000 nënshkrime.

Deputetët gjerman qenkan dukshëm të përmbajtur, ndërsa eurodeputetët francez dhe spanjoll treguan interesim të madh për

këtë çështje.

Numër i madh i iniciativave dhe aksioneve janë tashmë të hapura edhe në Francë, duke përfshirë edhe dy hetime penale dhe hetim administrativ për zbardhje të mashtrimeve.

Eurokomesarja për Treg të brendshëm Elzbieta Bienkowska shkaktoi shqetësim te eurodeputetët, me fjalët se pushteti ekzekutiv i Unionit nuk ka qëllim të veprojë, dorësa vendet-anëtare kanë zbatuar hetim kombëtare.

Në lidhje me këtë çështje, duket se Komisioni evropian nuk është i përgatitur të hapë çfarëdo qoftë lloj të hetimi. Megjithatë, eurodeputetët ende kanë mundësi të kërkojnë formimin e komisioni parlamentar anketues, që nuk paraqet detyrë e lehtë.

Eurodeputetët gjerman ashpër u kundërshtuan të vendimit për futjen e rregullave më të rrepta në votimin e pak kohe më parë në Parlamentin Evropian.

Eurodeputetët ftuan në teste ekologjike reale dhe të sakta me mundësi nëpërmjet detektimit laboratorik të tregohen rezultate të sakta për emetimin e oksideve të dëmshme të azotit.

<http://www.euractiv.com/sections/transport/european-parliament-calls-inquiry-volkswagen>



**"Sipas vlerësimeve,
në vendet e UE-së
lëvizin më shumë
se 11 milionë
automjete të
Folksvagen, me
softuer të futur me
të dhëna të
rrejshme"**

KRIZA E MIGRANTËVE NË FOKUSIN E TAKIMIT TË KËSHILLIT EVROPIAN



Më 15 tetor këtë vit liderët të Unionit Evropian mbajtën takim të përkushtuar krizës të migrantëve, që paraqite takim i katërt me radhë për vetëm gjatë muaj me temë kryesore - zgjedhja e krizës.

Unioni evropian dhe vendet-anëtare i përforcojnë përpjekjet për vendosje të politikë Evropiane të migrantëve efikase, humanitare dhe të sigurt.

Liderët të UE-së arritën pajtim për drejtime politike dhe prioritete për hapat e ardhshme:

për bashkëpunim me vendet të prejardhjes dhe vendet të tranzitit, me qëllim ndërprerjen e rrjedhave të migrantëve; Liderët të UE-së e pranuan planin e përbashkët aksionar me Turqinë dhe u pajtuan për arritjen e masave konkrete operative në Samitin të ardhshëm në Valetë, me shefat afrikan të shteteve pse qeverive;

për përforcimin e kufijve të jashtëm të UE-së dhe vendosje të sistemi të integruar për menaxhim kufitar, të cilat do të shkojnë jashtë nga mandati i Fronteksit, me dhënien e disa qindra zyrtarëve të rinj në kontrollet kufitare që të sigurohen sferat me qendra për pranim dhe regjistrim në Greqi dhe Itali;

për çështjen të kthimit dhe readmisioni;

për gjetjen e zgjedhjeve për presin nga migrimi;

për Samitin për migrim në Valetë më 11 dh 12 nëntor 2015.

Kryetari i Këshillit Evropian Donalld Tusk ngriti debat për sfidat më të gjera në politikën e migrimit të UE-së, në afat të mesëm dhe të gjatë. Liderët të UE-së biseduan për çështje të ndjeshme, për Regullativën nga Dublini, Sistemi Evropian i policisë kufitare dhe roli i veçantë i qendrave për pranim dhe regjistrim.

Në takimin ishin shqyrtuar vendimet të ndërmarra pas takimit të parë të jashtëzakonshëm të Këshillit Evropian në prill, si dhe bisedohej për nevojën nga zmadhimi i përkrahjes financiare për organizatat të cilat punojnë në regjion, si UNHCR dhe Programi botëror për ushqim, dhe përkrahja nga vende të treta.

këshilli evropian debatonte edhe për politikën dhe ngjarjet ushtarake në Siri, ndër të tjerat edhe për ndikimin e tyre në migrimin.

këshilli përsëri ftoi në zgjedhje politike të konfliktit në bashkëpunimin më të afërt me KB dhe vendet nga rajoni.

Ishte e përshëndetur ftesa e KB-së për emërim të qeverie të re të unitetit kombëtar në Libi.

Nga ana e Këshillit përsëri u përkujtua se procesi i përfundimit të unionit ekonomik dhe monetar doemos duhet të vazhdojë në mënyrë të hapur dhe transparente dhe me respektim të plotë të tregut të vetëm.

Gjithashtu Këshilli ishte i njohur me procedurën e ardhshme në lidhje me planin e Britanisë së Madhe për referendum.

<http://www.consilium.europa.eu/en/meetings/european-council/2015/10/15>

Click Here to upgrade to
Unlimited Pages and Expanded Features

R MARRËVESHJES PËR TREGTI TRANSATLANTIKE DHE

Marrëveshja për Tregti transatlantike dhe partneritet investues (TTPI) ndërmjet UE-së dhe SHBA-ve ka për qëllim t'i mënjanojnë barrierat të tregut në sferë të gjerë të sektorit ekonomik, ta lehtësojë blerjen dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve ndërmjet UE-së dhe SHBA-ve.

Organizatorët të Iniciativës evropiane qytetare "STOP TTIP" aktivitete e veta i drejtuan ndaj Gjykatës evropiane të drejtësisë. Edhe pse në korrik këtë vit ishte paralajmëruar se deri në fund të shtatorit iniciativa qytetare "STOP TTIP" duhet oficalisht të jetë e ngritur, Komisioni evropian përpiket ta bllokojë projektin.

Iniciative Evropiane Qytetare do ta prezantojë platformën e vet për qytetarët si dhe propozim ligjdhënës te Komisioni. Për këtë të mundësohet do të jenë të nevojshme të grumbullohen 1 milionë nënshkrime.

Bisedimet ndërmjet SHBA-ve dhe Unionit Evropian për Tregti Transatlantike dhe Partneritet investues filluan në korrik të vitit 2013. Nëse marrëveshja nënshkruhet,

ajo do të ndikojë në pothuajse 40% të BPV-së botërore.

Marrëveshja për krijim të tregu të madh transatlantik ndërmjet Evropës dhe SHBA-ve është një nga më të rëndësishmit në botë, i cili është 2 miliardë euro të mallra dhe shërbime në nivel vjetor. Nëse është i suksesshëm, marrëveshja do të mund të ndihmojë kompanive të përfitojnë miliona euro dhe do të jetë i fundit në hapjen e mijëra vendeve të reja të punës nga të dyja anët të Atlantikut.

Amvisëri mesatare evropiane në vjet mund të kursejë deri në 545 euro, me ç'rast pritët zmadhimi i BPV-së për 0,5%.

Edhe krahas asaj që Komisioni Evropian e refuzoi propozimin e një nga aleancat të UE-së aktivitetet të mbajnë Iniciativë evropiane qytetare kundër TTIP, organizata të pavarura me të gjithë Evropën vazhdojnë me lobim kundër marrëveshjes.

<http://www.euractiv.com/sections/trade-industry/commission-opposes-european-citizens-initiative-against-ttip>



NGA NËNTORI BANKËNOTË E RE PREJ 20 EURO

Bankënota e re prej 20 euro do të jetë e lëshuar në qarkullim prej 25 nëntori 2015.

Supozohet se gjenerata e re e eurove do të jetë shumë më e sigurt dhe më me afat më të gjatë të përdorimit.

Sipas Bankës qendrore evropiane, me shenjat të reja të sigurisë do të jetë shumë më vështirë të falsifikohen bankënotat të redizajnuara.

Bankënota e redizajnuar prej 20 euro dhe me madhësi 133 x 72 mm dhe është bërë në stilin gotik.

Pas bankënotës prek pesë euro në maj të vitit 2013 edhe bankënota prej 10 euro nga shtatori i viti 2014, kjo është bankënota e tretë e re nga seria "Evropa".


Për euro bankënotat ka shtatë denominime edhe atë prej: 5, 10, 20, 50,100, 200 dhe 500 euro. Ato janë në madhësi të ndryshme dhe ngjyrë, në versin e bankënotave është dhënë tregim i periudhave të ndryshme të historisë arkitektonike të Evropës.

<http://www.new-euro-banknotes.eu/Euro>

<https://www.ecb.europa.eu/euro/>



BUJQESIA EVROPIANE NE EREN E TEKNOLOGJISË TË RE



**"Për bujqësi precize,
Komisioni Evropian
siguron përkrahje
financiare prej mbi
78 miliardë euro
nëpërmjet UE
programit Horizont
2020"**

Në përpjekje të jepet përgjigje në nevojat të rritura globale për ushqim dhe zgjedhje të problemit të ndotjes të mjedisit jetësor, sektori evropian i bujqësisë hynë në erën digjitale. Bujqit nga UE-ja edhe më shumë i shfrytëzojnë teknologjitë të reja për zmadhim të prodhimit, për kualitet më të mirë me përdorim më të vogël të repromaterialeve bujqësore si dhe ndotjes më të vogël të mjedisit jetësor.

teknologjitë të reja më shumë i pranojnë edhe futin në prodhimtari bujqit të mëdhenj, ndërsa për bujqit të vegjël teknologjitë janë më të shtrenjta dhe të pakapshme.

Rritja e popullatës botërore rezulton me zmadhim të kërkesës të prodhimeve bujqësore, por njëkohësisht zvogëlohen mundësitë për kënaqje të kërkesës për shkak të zvogëlimit të tokës të përpunueshme dhe ndryshimet klimatike.

analistët si zgjedhje inovative për këtë problem shikojnë në të ashtuquajturën bujqësi precize ose të planifikuar, përkatësisht "revolucioni agro-teknologjik".

Bujqësia precize bazohet në investim optimal në sipërfaqen në lidhje me përfitimin e nevojshëm. Bujqësia e tillë përfshin përdorimin e incizimeve satelitore si GPS dhe internet me qëllim të sigurohet kontroll i prodhimit dhe zvogëlim i përdorimit të plehrave, pesticideve dhe uji.

Futja e teknologjisë të re u ndihmon bujqve më mirë dhe në mënyrë më të qëndrueshme të menaxhojnë me fermat duke mbajtur llogari për të gjitha detajet në prodhimtari.

Bujqit të cilit punojnë në bazë të të dhënave precize mund në mënyrë më të mirë t'i shfrytëzojnë inputet kimike (pesticide dhe plehra) që është e rëndësishme për mbrojtjen e tokës dhe ujërave nëntokësor dhe kontribuojnë për rritjen e efikasitetit të prodhimit. Në të njëjtë kohë përmirësohet kualiteti i prodhimit, ndërsa konsumimi i energjisë dukshëm zvogëlohet.

Me përdorimin e sensorëve bujqit mund të zbulojnë pjesë të tokës për të cilat

është e nevojshme trajtim i veçantë edhe atë me futjen e kimikaleve mund të drejtohet në vende të caktuara. Në këtë mënyrë zvogëlohen sasia e kimikaleve dhe mbrohet mjedisi jetësor.

Në praktik është e ndryshme në lidhje me atë tradicionale sipas së cilës masat për ujtitje, plehërim, spërkatje me insekticide dhe herbicide zbatohen në të gjithë rajonin, pa dallim nëse të njëjtat janë të nevojshme ose jo.

Ekspertët vlerësojnë se tregu i të ashtuquajturës bujqësi precize në vitin 2014 në nivel global është 2,3 miliardë euro. Me rritje të pritur me shkallë vjetore prej 12% deri në vitin 2012, për tregje më perspektive konsiderohen tregjet në SHBA dhe Evropë.

Qendra e përbashkët e hulumtimit e Komisionit Evropian në raportin e sivjetmë vërtetoi se bujqësia precize mund të luaj rol të rëndësishëm në kënaqjen e kërkesës të zmadhuar për ushqim dhe njëkohësisht të sigurojë shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe mbrojtjes të mjedisit jetësor.

Me Politikën e re të përbashkët bujqësore 2014-2020 janë siguruar masa financiare stimuluese dhe masa për përkrahje të bujqve për investim në teknologjitë për bujqësi precize, për shembull në makina të cilat në mënyrë precize e dozojnë plehun.

Zbatimi i teknologjive të reja në bujqësi ishte pjesë e programit edhe të përbërjes paraprake të Komisionit Evropian nëpërmjet partneritetit evropian inovativ për produktivitet dhe qëndrueshmëri në bujqësi (EIP-AGRI).

Komisioni për bujqësi precize siguron përkrahje prej mbi 78 miliardë euro nëpërmjet programit Horizont 2020.

<http://www.euractiv.com/sections/innovation-feeding-world/europe-entering-era-precision-agriculture>

[Click Here to upgrade to
Unlimited Pages and Expanded Features](#)

DITË E HAPURA - JAVA EVROPIANE E REGJIONEVE DHE QYTETEVE

Prej 12 deri në 15 tetor në Bruksel për herë të 13-të u mbajt manifestimi "Ditë të hapura - Java Evropiane e regjioneve dhe qyteteve", në të cilën merrnin pjesë rreth 6000 përfaqësues, 600 bisedues prej mbi 200 regjione dhe qytete nga e gjithë Evropa.

Në pjesën e punës të kësaj ngjarje tradicionale katër ditore ishin mbajtur mbi 100 punëtori, debate, prezantime, ekspozita dhe mundësi të prezantuara për rrjetëzim.

Manifestimi Ditë të hapura - Java evropiane e regjioneve dhe qyteteve paraqet ngjarje tradicionale, e cila për herë të parë është organizuar në vitin 2013 nga ana e Komitetit të regjioneve në UE.

Qytetet dhe regjionet nëpërmjet të kësaj ngjarje kanë mundësi të prezantohen dhe ta përmirësojnë bashkëpunimin në nivel lokal dhe regional, të këmbejnë përvoja dhe praktika të mira në më shumë sfera, si zhvillim ekonomik dhe inkluzion social, partneritet publik-privat, bashkëpunim tejkufitar, inovacione regjionale dhe zhvillim ekonomik lokal.

Në korniza të këtij ngjarje tradicionale,

qyteti i Shkupit për herë të parë organizonte edhe pranim të hapur i cili mbahet në Misionin e Përhershëm të Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian në Bruksel, ku numër i madh i ambasadorëve, eurodeputetë, diplomatë dhe pjesëmarrës në "Ditët të hapura" kanë mundësi të kënaqen në kuzhinën tradicionale maqedonase, verë dhe muzikë maqedonase.


Në kuadër të manifestimit, përfaqësues të Komisionit Evropian, të qyteteve evropiane, dhe kryetari i komunës Koce Trajanovski e nënshkruan "Konventën të gjelbër digjitale" me të cilën qytetet obligohen të ndërmarrin aktivitete për zvogëlimin e pasojave nga ndryshimet klimatike nëpërmjet shfrytëzimit të teknologjive informatike dhe të komunikimit për zhvillim.

Qyteti i Shkupit u bë qyteti i 48-të në Evropë i cili e ka nënshkruar këtë konventë dhe qyteti i parë nga vendet të Ballkanit Perëndimor.

http://ec.europa.eu/regional_policy



**13th European Week of
Regions and Cities**
Brussels 12-15 October 2015





Në zgjedhjet parlamentare në Poloni të cilat u mbajtën më 25 tetor këtë vit, partia opozitare e kryesuar nga euroskeptiku i njohur polak Jarosław Kaçinski fitoi shumicë absolute.

Partia Polake opozitare euroskeptike E drejtë dhe drejtësi (PIS) e Jarosław Kaçinski, vëlla binjak i kryetarit të humbur polak Leh Kaçinski, fitoi 242 mandate në Dhomën e Poshtme të parlamentit i cili numëron 460 mandate. Me mandatet të fituara është hapur mundësia për formim të qeverie, pa partnerë të koalicionit.

Platforma qytetare e djathë-qendrore (PO) e cila ishte në pushtet 8 vitet e kaluara, ka fituar 133 vende të deputetëve.

Kryeministresje aktual polak dhe kryetare

e platformës qytetare e djathë-qendrore, Eva Kopaç e pranoi humbjen në zgjedhjet parlamentare.

Partia konservatore (PIS) kundërshtohet në pranimin e imigrantëve nga Lindja e Afërme dhe nga Afrika, dhe paraqitet si rojtar i vetëm i vlerave, interesave nacionale dhe sigurinë të Polakëve.

Për herë të parë në historinë e Polonisë për vendin e kryeministrit pretendonin dy gra - Beate Shillo dhe Eva Kopaç.

Dalja për zgjedhjet parlamentare qenka 51,6% prej 30,5 milionë votues të regjistruar, që është dalje më e madhe nga zgjedhjet e kaluara parlamentare të mbajtura në vitin 2011.

<http://mondo.rs/a842068/Info/Svet/Izbori>

PARALAJMËRIME TË REJA SHËNDETËSOREN PAKETIMET TË CIGAREVE



Më 9 tetor këtë vit ishte miratuar akti për implementimin e masave të reja për paralajmërim për shëndetin në të gjitha pakot të duhani për pirje (cigare dhe të mbështjella nga duhani), në pajtim me Direktivën e prodhimeve të duhanit (2014.40 / UE).

Masat të reja janë në drejtim të kthimit nga përdorimi i duhanit, veçanërisht te popullata e re.

Paralajmërimet shëndetësore të cilat do të qëndrojnë në pakot me cigare, do të ketë fotografi në ngjyrë dhe tekst i cili paralajmëron për dëmin nga pirja e duhanit dhe informata për lënie.

Sipas rregullave të reja, 65% nga pakot do të jenë të mbuluara me

Masa e miratuar për zbatim jep specifikime teknike për dizajnin e pakove me cigare, dizajni dhe forma e paralajmërimëve të kombinuara shëndetësore duke i marrë parasysh format të ndryshme të paketimi.

Pritjet janë se masat e reja për paralajmërim shëndetësor do të jenë më të dukshme dhe se do të paraqiten në të gjitha paketimet të cigareve në UE prej maji 2016.

http://ec.europa.eu/dgs/health_food-safety/dyna/enews/enews.cfm?

[Click Here to upgrade to
Unlimited Pages and Expanded Features](#)

Në zgjedhjet parlamentare në Portugal të cilat u mbajtën më 4 tetor këtë vit, koalicioni qeveritar e qendrës të djathtë "Portugalia përpara" (e përbërë nga Partia social-demokrate, Qendra social-demokrate dhe Parti konservatore e popullit) fitoi 107 nga 230 vendeve në Parlament.

Edhe krahas fitores në zgjedhjet, Koalicioni qendror-djathtistë e humbi shumicën absolute në Parlament të cilin e kishte nga viti 2011. Kryeministri aktual i Portugalisë Pedro Passos Coelho, mori rast sërish ta formoj qeverinë e Portugalisë.

Koalicioni qendror-djathtist fitoi 38,5% nga votat edhe krahas zbatimit të politikave të kursimit në Portugalinë e ngarkuar me borxh e cila në vitin 2011 doemos duhej të marrë kredit për ndihmë financiare prej 78 miliardë euro.


Koalicioni qeveritar e humbi shumicën absolute në Parlament që do të thotë se deputetët nga blloku i majtë do të mund t'i bllokojnë reformat ekonomike dhe masat për zvogëlim të borxhit.

Partia socialiste fitoi 32,4% të votave dhe gjasë më të madhe për koalitim me bllokun e majtë të pakicave, i cili lufton kundër masave të kursimit si dhe me Partinë komuniste e cila është kundërshtarë e eurozonës. Blloku majtist dhe Partia komuniste angazhohet edhe për dalje të Portugalisë nga NATO-ja. Partitë majtiste dhe qendra së bashku kanë 122 deputetë.

Në Zgjedhjet kishte dalje të dobët rekorde të votuesve, 43,07% nga gjithsej 9,6 milionë me të drejtë vote.

Rezultatet të votimit nuk premtojnë stabilitet të qeverisë së re të Portugalisë. Asnjë nga 19 qeveritë të Portugalisë të zgjedhura pas viti 1974 e cila nuk ka pasur shumicë absolute në parlament, nuk e kanë përfunduar mandatin deri në fund.

Në Parlamentin e Portugalisë i cili është i përbërë prej 230 mandatë të deputetëve, koalicioni djathtist e kryesuar nga Pasos Koelljo ka 104 mandate, socialistët 85 mandate, blloku e majtë 19 dhe komunistët 17 mandatë të deputetëve.



Fitorja e koalicionit qeveritar i kushtohet më shumë faktorëve. Spektri i majtë politik nuk është i vetëm, përkatësisht socialistët, blloku i majtë dhe komunistët edhe pse në bashku kanë fituar 60% të votave, tepër dallohen pas çështjet thelbësore (NATO, euroja, politikat të kursimit) që të formojnë qeveri të koalicionit. Disperzioni i votave dukshëm ndikon në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve: duke falënderuar D'hond metodës të shndërrimit të votave në mandate rreth 830.000 vota do të jenë të dhëna partive të vogla dhe listat, dhe i kanë takuar koalicionit qeveritar.

Me kujdes priten zgjedhjet në Spanjë të cilat do të mbahen më 20 dhjetor këtë vit. Vendi mund të ballafaqohet me problem të ngjashëm gjatë formimit të qeverisë duke pasur parasysh përkrahjen të zvogëluar për partitë qeveritare dhe paraqitjen e partive të reja në skenën politike.

Derisa BPV-ja e Portugalisë përbën më pak se 2% nga BPV-ja e eurozonës, Spanja është e katërta ekonomi sipas madhësisë në zonë dhe trazirat politike në atë vend mund ta kthejnë kontinentin në periudhën e pasigurisë ekonomike.

Parashikohet se në Spanjë, rezultati nga gara votuese në 20 dhjetor këtë vit, ndërmjet dy partive spanjolle tradicionalisht që paraprijnë dhe dy parti të sapoformuara do të jetë i pazgjidhur, përkatësisht asnjë parti nuk ka të marrë shumicën absolute.

**"Edhe krahas fitores
në zgjedhjet,
Koalicioni qendror-
djathtiste e humbi
shumicën absolute
në Parlament të cilin
e kishte nga viti
2011"**

[http://www.euronews.com/tag/
portuguese-election/](http://www.euronews.com/tag/portuguese-election/)

RAIF BADAVI FITUESI I SHPËRBLIMIT SAHAROV PËR LIRI TË MENDIMIT PËR VITIN 2015



"Bloggeri saudit Raif Badavi është fitues i shpërblimit Saharov për liri të mendimit për vitin 2015"

Bloggeri saudit Raif Badavi është fitues i shpërblimit Saharov për liri të mendimit 2015, me vendim të kryetarit të Parlamentit Evropian, Martin Shulc.

Për momentin, Badavi vuan burg prej dhjet vite për ofendim të islamit nëpërmjet internet faqes të tij në të cilën e promovon bisedën e lirë për shoqërinë, politikën dhe religjionin.

Ceremonia e ndarjes të shpërblimeve do të mbahet në Strasburg, më 16 dhjetor 2015. Kryetari i Parlamentit Evropian Martin Shulc e ftoi mbretin e Arabisë Saudite ta ndërpres zbatimin e dënimit dhe ta lirojë Budavin nga burg, që t'i kthehet familjes së tij, si dhe të mund të marrë pjesë në sesionin plenar të PE në dhjetor edhe oficalisht ta marrë shpërblimin.

Raif Badavi është blogger nga Arabia Saudite, shkrimtar dhe aktivist i cili lufton për të drejtat e njeriut dhe redaktor i faqes "Liberalë të Lirë Saudit". Badavi qenka i burgosur në vitin 2012, ndërsa më vonë edhe i dënuar në dhjet vjet burg, një mijë goditje me kamxhik dhe dënim të lart në para për ofendim të vlerave islame nëpërmjet bllogut të tij.

Goditjet e para me kamxhik në publik i ka marrë në janar këtë vit, ndërsa pjesën tjetër është e obliguar për shkak të presionit të madh ndërkombëtar.

Në shkurt këtë vit, Parlamenti Evropian miratoi rezolutë me të cilën dënohet

kamxhikimi i Raif Badavit si akt i ashpër dhe shokues i pushteteve në Arabi Saudite, me kërkesë e njëjta të ndërpritet dhe lëshim pa kusht në liri, sepse Badavi konsiderohet për i burgosur i vetëdijes, i paraburgosur dhe dënuar vetëm se e shfrytëzon të drejtën e tij të lirisë të shprehjes.

Shpërblimi Saharov për liri të mendimit ndahet çdo vit nga ana e Parlaemntit Evropian. Me shpërblimin dekorohen individ zë jashtëzakonshëm dhe organizata të cilat luftojnë kundër jotolerancës dhe shtypjes.

Shpërblimi ishte i themeluar në vitin 1998. Në vitin 2014 shpërblimi ishte i ndarë Denis Makvezh, luftëtar për të drejtat të vajzave dhe grave nga Republika Demokratike e Kongos.

Nominimi për shpërblimin Saharov mund të propozojnë grupe parlamentare ose grupe prej më së paku 40 deputetë.

Komisioni për punë të jashtme i Komisionit për zhvillim do të votojë pas propozimeve për zgjedhje të tre finalistëve, ndërsa mandej Konferenca e kryetarëve zgjedh një laureat.

<http://www.europarl.europa.eu/sakharovprize/en/home/the-prize.html>



ANDREJ SAHAROV - inspirim për shpërblim

Fizikanti rus Andrej Dmitrievič Saharov (1921-1989) është fitues i Shpërblimit Nobel për paqe në vitin 1975, ndërsa është bërë i njohur si baba i Bombës Hidrogjene Sovjetike.

I brengosur për implikimet të cilat puna e tij do ta kenë mbi të ardhmen të njerëzimit, ka këmbëngulë në ngritjen e vetëdijes për rrezikun nga gara me armatimin nuklear. Përpjekjet e tija qenkan pjesërisht të suksesshme me nënshkrimin e Marrëveshjes nga viti 1963 për ndalesë për testim nuklear.

Në vitin 1970 e ka themeluar Komitetin për mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe viktimave të gjykimit politik. Pushtetet sovjetike e kanë dëbuar Saharov në Gorki ku ka marrë veshë se Parlamenti Evropian dëshiron shpërblim për liri të mendimit i cili do ta mbajë emrin e tij. Në vitin 1987, Saharov ka dërguar porosi te Parlamenti Evropian me të cilën ka dhënë leje shpërblimi ta mbajë emrin e tij dhe në të njëjtën shikon si nxitje ndaj të gjithë ata të cilit si ndaj tij janë përkushtuar në luftën për të drejtat e njeriut.

Click Here to upgrade to
Unlimited Pages and Expanded Features

REFORME PËR RREGULLAT PËR MBROJTJE TË TË DHËNAVE

Privatsia dhe mbrojtja e të dhënave janë të drejta bazë në UE. Mbrojtja e të dhënave personale është e drejtë fundamentale, mbrojtja me të drejtën evropiane të përcaktuar në nenin 8 të Deklaratës për të drejta fundamentale të UE-së.

Më 9 tetor këtë vit, Supervizori Evropian për mbrojtje të të dhënave e shpalli rekomandimin për Rregullativën për mbrojtje të të dhënave.

Këshilli i UE-së arriti pajtim të përgjithshëm për reformën e propozuar të Direktivës të UE-së për mbrojtje të të dhënave personale, e cila ka të bëjë me procedurat policore dhe penale.

Më 27 tetor këtë vit, Supervizori Evropian për mbrojtje të të dhënave e shpalli rekomandimin për dispozitat operative të Rregullativës për mbrojtje të të dhënave. Si reflektim i tre versioneve të tekstit të propozuar të Komisionit, Parlamenti Evropian dhe Këshilli, rekomandimet të EDPS dhanë kontribut në bisedimet rrjedhëse trilaterale për pakon të reformave.

Njëkohësisht, Supervizori evropian për mbrojtje të të dhënave lansonte aplikim mobil për zbatim të teksteve të Komisionit, Parlamenti dhe Këshilli, si dhe rekomandimet të Supervizorit

Evropian, për qasje më të lehtë nëpërmjet tableti dhe celular të mençur.


Arritja e marrëveshjes për Direktivën për mbrojtje të të dhënave nga ana e Këshillit është e rëndësishme për përparimin e dialogut sepse ajo paraqet pjesë e rëndësishme e pakos të reformave.

Propozim-direktiva e përfshin përpunimin tejkufitar të të dhënave në bashkëpunimin policor dhe gjyqësor dhe është i dedikuar për mbrojtje të transfereve të vendit dhe ato tejkufitar të të dhënave.

Më 25 janar 2015, Komisioni Evropian e miratoi pakon e reformave i cili përbëhet nga dy propozime ligjdhënëse: Rregullore e përgjithshme për mbrojtje të të dhënave (në mënyrë të drejtpërdrejtë të zbatueshme në të gjitha vendet anëtare) dhe Direktivë e posaçme (transponohet në ligjvënien kombëtare) për mbrojtje të të dhënave në sferën e policisë dhe jurisprudencës.


Propozimet të Komisionit, amendamentet të Parlamentit Evropian dhe qëndrim i përbashkët i Këshillit konsiderohen për dialog takime me përfaqësues nga tre institucionet të cilat kërkojnë të bisedohet për marrëveshjen për kompromis.

<https://secure.edps.europa.eu>



UE KALENDAR/nëntor 2015

- Samit i kushtuar migrimit 11-12/11/2015, Valetë, Maltë;
- Samit për investime në bioekonomi 9-11/11/2015, Bruksel, Belgjikë;
- Seancë e Parlamentit Evropian 11/11/2015, Bruksel;
- Java Evropian për luftë kundër krimit të organizuar 16-19/11/2015, Bruksel,
- Seancë plenare e Parlamentit Evropian 23-26/11/2015, Strasburg;
- Takim i këshillit të UE-së për punë të jashtme 27/11/2015, Bruksel
- Forum kulturor evropian 26-27/11/2015, Bruksel.



The screenshot shows the 'European Union Newsroom' website with the 'Calendar' tab selected. It features a search bar, navigation links (Home, Highlights, Press releases, Calendar, Audiovisual, Press contacts, Press facilities, About the EU), and a 'CALENDAR' section. Under 'BROWSE FORTHCOMING EVENTS', there are filters for 'By topic', 'By organiser', and 'By type'. To the right, a 'BY MONTH' calendar for November 2015 is displayed, showing dates from 1 to 30.



KUVENDI I REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË

UE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Tetori nr. 10, Shkup, 1000

Tel +389 2 3 11 22 33 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra: 019

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011-qershor 2012 ishte zbatuar IPA Projekti për "Ndihmë teknike për Parlamentin", qëllimi i përgjithshëm i të cilës ishte përforsimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me atë përmirësim të transparencës dhe përgjegjësisë të saj para qytetarëve.

Në korniza të IPA projektit, ishte siguruar ndihmë financiare dhe profesionale për vendosje të BE qendrës në Kuvend.

Qëllimi i formimit të BE qendrës është deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit t'u sigurohet qasje më e mirë në informata të lidhura me BE çështjet.